



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E lidhur me datën 08.07.2019 ne Lipjan ndërmjet:

Komunës se Lipjanit-Drejtorati i prokurimit te cilën e përfaqëson z. Adem Duriqi ne njërën ane (në tekstin e mëtejme) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit NTSH "Nord", Prishtinë të cilën e përfaqëson Nita Macula (në anën tjetër) në tekstin e mëtejme kontraktuesi.

Titulli i kontratës: Furnizim me inventar për nevojat e K.Lipjan

me numër Identifikues 613 019 078 136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizim me inventar për nevojat e K.Lipjan**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim të kontratës dhe furnizimet duhet te kryhen brenda 10 dite

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve: është **Depoja e Komunes Lipjan**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm për kryerjen e **Furnizim me inventar për nevojat e K.Lipjan** shprehur në shifra është **7483.00€**; shprehur me fjalë, shtatmije e katerqind e tetedhjet e tre/ Eurp/e zero /cent/.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1-më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të bëhet pasi që menaxheri i kontratës të hartoj raport me shkrim për përfundimin e të gjitha furnizimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, në mënyrë që të përcaktojë nëse furnizimet e kërkuara kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

9.2 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit. Kontraktuesi do të garantojë edhe se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj

obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqip* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik




Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nita Macula	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	Pronare	Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09.07.2019	Data:	09.07.2019
Vula:		Vula:	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

LISTA E QMIMEVE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi	Çmimi total €
				DDP[1] - €	
1	Tavolinë pune I Tavolinë pune, nga materiali mediapan MDF kualitative, trashësia 2x1.8cm 3.6 cm me shirit anësor ABS prej 2mm. Dimensionet 150cmx90cmx80cm. Ana ballore e tavolinës duhet të jetë e mbyllur me materialin e njëjte me tavolinën. Tavolina duhet të ketë vrimën për kablllo	Cope	3	130	390
2	Tavolinë pune, nga materiali mediapan MDF kualitative, trashësia 3.6 cm me shirit anësor ABS prej 3.6 cmmm. Dimensionet 120cmx80cmx75cm. Ana ballore e tavolinës duhet të jetë e mbyllur me materialin e njëjte me tavolinën. Tavolina duhet të ketë vrimën për kablllo.	Cope	2	120	240
3	Tovolin Tavoline me dimensione 160*90*72cm me material nga mediapna MFF, ngjyra te perzgjedhet nga organi mbykqys. me diminzione 160x90x72 	Cope	2	65	130
4	Karrige lëvizëse e kualitetit te larte Karrige lëvizëse hidraulike material i karrikeve te jete me kembe te kromuara nga lekure ose ekuivalent me lekure me dorza me nga alumini me mundesi ngritje ,, të kualitetit të lartë, Sipas Fotografisë se bashkangjitur 63x69xH108-118 cm 	Cope	15	75	1125
5	Karrige zyre material i lekur ose skaj i kualiteti te larte me rrota,hidraulike me mbajtese per duar te kromuar dhe te mbeshteshtjellura nga lekura , strukturë metalike me yll pese rremesh te kromuar ,, zezë, 63x69xH108-118 cm 		13	59	767
	Karrika statike pa krahë, strukturë metalike, tapiceri tekstili, 54x58xH81cm				

6		cope	16	15	240
7	Kasetë lëvizëse Kasete lëvizëse nga mdiapani me katër sirtar me qelës dimensionet 40 cm x 70 cm x 50 cm	Cope	3	55	165
8	Furnizimi dhe transporti i karrikave standarde nga druri kualitet i larte ngjyra percaktohet nga ak 	Cope	10	26	260
9	Vitrinë Vitrine e përpunuar nga MDF I palstifikuar, me cilesi te larte Dimenzionet :Lartesia 200 cm, gjersia 90 cm,thellësia 40 cm,trashësia e kornizave te vitrinës duhet te jete 3.60 lart dhe posht .cm,me 5 radte per dokumete –trashesia e radteve 3.60 cm	Cope 	2	120	240
9	Furnizimi dhe transporti i raftit me dimensione 163*153cm, materiali nga mdiapani trasia 1.8 cm, ngjyra te caktohet nga organi mbykqys.	Cope	1	120	120
10	Varese rrobash nga druri me me 8-10 rrema trashsia e shtylles 4 cm kub dru masiv me lartesi nga 1.80-1.90 meter	Cope	8	17	136
11	Furnizimi me materjal dhe vendosja e perdeve ne dritare me dimensione 150x160cm lloji I perdeve sangrill me mekanizem per hapje dhe mbyllje	Cope Dritare	25	38	950
12	Perde shiritore	M2	55	12	660
13	Fotele tradicionale - Ngjyra e mbulesës:me ngjyra - Materiali i trupit:dru - Thellësia e mobiljeve:90 cm - Gjerësia e mobiljeve:85 cm - Lartësia e mobiljeve:93 cm - Lartësia e vendndodhjes:40 cm - Gjerësia e vendndodhjes:55 cm - Thellësia e vendndodhjes:55 cm statike	Cope 	6	100	600
14	Karta per arkiv me dimensione 220x100x45cm (me pese rafta materiali nga mdiapani trasia 1.8 cm, ngjyra te caktohet nga organi mbikqys'.	Cope	9	140	1260

15	Ormana metalik me dy dyer dimenz 190x80x40cm me rafta	Cope	2	100	200
Totali i Përgjithshëm:					7483